

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, departamenti I per gjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti, ne cështjen e inicuar me padine e paditeses [REDACTED] [REDACTED] me seli ne Prishtine, kunder te paditurit [REDACTED] nga fsahti [REDACTED] Kacanik, per rimbursim te demit, me date 06.06.2016, jashtë sëancës ka marre kete:

### A K T G J Y K I M

#### -pa shqyrtim kryesor te cështjes -

**REFUZOHET**, ne teresi si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësesh [REDACTED] Prishtine me seli ne Prishtine, me te cilën ka kerkuar që te detyrohet i padituri t'i ia rimburson demin ne shumë prej 1,450.00€, me kamaten ligjore dhe shpenzimet e procedures, dem te cilin paditesja i ka kompensuar personit te trete [REDACTED], per shkak te aksidentit te dates 30.06.2008.

**OBLIGOHET** paditesja që të paguan taksën gjyqesore per padi dhe aktgjykim ne shumë prej 30.00€, pas pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenimin e pasojave juridike.

#### A r s y e t i m i

Paditesja ka ushtruar padi kunder te paditurit, me pretendimin se per shkak te veprimeve deliktore te te paditurit gjate pjesemarrjes ne komunikacion, paditesja eshte detyruar qe te kompensoj demet ndaj personit te trete [REDACTED] pas procedures civile qe ka inicuar I njejtë kunder paditeses, e cila ka rezultuar me perfundim me pajtim jashtegjyqesore.

Gjykata, pasi qe ka shqyrtuar shkresat e lendes, ka obliguar te paditurin qe te parashtron perjigje ne padine e paditeses. I padituri ne perjigjen e tij ne padi, ka paraqitur prova te vlefshme, patente shoferin e leshuar me date 29.05.1998, nga e cila vertetohet se pretendimet e paditeses se i njejti ka drejtuar automjetin papotent shofer nuk gendrojne dhe mbi kete baze nuk ekzistojn pretendimet e padise dhe per pasoje e njejta ka rezultuar si e pathemelt.

Nga sa u tha me siper eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi bazur ne nenin 152 te LPK-se.

Per shpenzimet e procedures, gjykata ka vendosur ne baze te UA nr.2008/2 te KGJK-se, per unifikimin e taksave gjyqesore

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.414/15 date 06.06.2016



**Keshilla Juridike:** Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne gjykaten e Apert te Prishtine, permis kesaj gjykate.

REPUBLICA E KOSOVËS  REPUBLICA KU.

